

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI KONTRAKTOR

DREJTORIA RAJONALE OSSH sh.a FIER

Adresa : Lagja "1 Maj", Rr. "Enriko Veizi", Fier"

Nr._____ Prot.

Fier, më __ /__ /2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është përfshirë publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

Rikonstruksioni i rrjetit TU dhe kabinave të Fiderit Strum, Roskovec 3, Nënstacioni Matkë 35/10 kV

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (**CPV**):

Linja ajrore te energjise elektrike **31321100-3**

VLERA E FONDIT LIMIT: **32,487,232.34**(tridhjete e dy milion e katerqind e tetedhjete e shtate mijë e dyqind e tridhjete e 2 pike tridhjete e kater)leke , pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria Rajonale Ossh sha Fier** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- Sigurim oferte, sipas Shtojcës 8;*
- Formulari përmbledhës i vetdekalarimit, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. *kopje të deklaratave, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vjetet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 100% e vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuar për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin Nr. 9920 , datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktiveve të Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Kërkesa konsiderohet e përbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuar nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqese vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) per shlyerjen e taksave vendore te maturuara per vitin 2024 (per NIPT-in kryesor dhe per NIPT-et sekondare), sipas parashikimeve ligjore ne te gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Komuna ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR-se.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kérkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjisacionit të fushës, konkretisht, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatiore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatiore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Eksperitzen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përparrë publikim të tyre, nga ekspertri kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standartet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimitaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Përcaktimi i viteve të kérkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatiore": "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatushme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të ketij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatiore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe mënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kérkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Gjithashtu ne lidhje me kerkesen per pagesen e taksave vendore referojme se në bazë të pikave 1 dhe 3, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në Kreu II, Taksat vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i Ndryshuar).

Me anë të kriterit per te paraqitur dokumentacionin e shlyerjes se taksave vendore kërkohet që operatorët ekonomikë te vertetojne se ushtrojne aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjisacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **16,243,616.2**(gjashtembedhjete milion e dyqind e dyzet e tre mijë e gjashteqind e gjashtembedhjete pike dy) lekë dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b)punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet dhe konkretisht **64,974,464.6** (gjashtyedhjete e kater milion e nenteqind e shtatedhjete e kater mijë e katerqind e gjashtedhjete e kater pike gjashte)leke.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.2.2 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjeter, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat jo me te vogel se 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose 2 fishi i vleres se fondit limit , për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: (*Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngashme brenda këtij marzhi.*)

2.2.3 *Liçensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

Operatori Ekonomik duhet te disponoje Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|---|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • N.P-1 (Punime germimi e toke)
LEKE • N.P-11 (Ndertime per N/stacionet, kab transformatoreve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjisë) | Klasifikimi A (0- 20 MILION)
Klasifikimi B (21-50 MILION) LEKE |
|---|---|

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë, të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, të Republikës së Shqipërisë.

Argumentimi: Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe _ VENDIM Nr.42, datë 16.1.2008 për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).

Kategoritë e kërkuar janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në

		kategorinë përkatëse		kategorinë përkatëse
N.P-1	Punime germimi e toke)	Germim dheu me esvakator me goma 0.25 m ³ ne kanale me gjeresi deri 2 m ,prani uji kat III me shkarkim ne toke, Germim dheu me esvakator me goma 0.25 m ³ ne kanale me gjeresi deri 2 m ,prani uji kat III me shkarkim ne mjet, Germim me krahe seksion detyruar me gjeresi $b < 1 \text{ m}$, $h=1.5 \text{ m}$, toke e zak. per mur mbajtes, etj	A	0-20 milion leke
N.P-11	(Ndertime per N/stacionet, kab transformatoreve, linja e TN e te mesem dhe shperndarjen e energjise	Punime Izolimi, etj Montim transformator shperndares $250 \div 560 \text{ kVA}$, $20/10/6/0.4 \text{ kV}$, Montim ura TM 20 kV (e transformatorit, Montim Ura TU zbara(e transformatorit) etj	B	21-50 milion leke

2.2.4 Një punësim mesatar i të paktën 30 (tridhjet) punonjesve, për periudhën maj 2024- korrik 2024.

**Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.8. Ndersa operatori ekonomik
fitues, para lidhjes se kontrates, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë
kerkohet i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar si më poshtë:**

- a) List pagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet
nga legjislacioni ne fuqi per peridhen maj 2024- korrik 2024..

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me
kontratë punë te vlefshme, diplome/deshmi përkatëse leshuar nga institucione te akredituara nga autoritetet
pergjegjese shteterore, dëshmi kualifikimi te sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat
Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e
punonjësve), si dhe te figurojne ne listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, si më poshtë:

- 12 (dymbedhjete) punonjës elektricist
- 4 (e) prej tyre (Kategoria III) ose me larte pjesa tjeter te jene te pajisur me IQT per
elektricist

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar.

2.2.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, te perfshire ne licensen e shoqerise, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi inxhinierik si më poshtë:

Ing. Gjeodet 1(nje)

Ing. Elektrik 1(nje)

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar:

2.2.7 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe te jete Ing. Elektrik dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme
- b) Diplomë

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar:

2.2.8 *Operatori Ekonomik për të realizuar objektin e prokurimit duhet të ketë të paktën 3 (tre) punonjës automakinist. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), dëshmi e aftësisë profesionale dhe lëshuar nga institucionet përkatëse*

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më sipër i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar:

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kerkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Tek Pika 2.2.5 ku elektricistet kerkohen te ndare sipas kategorive kjo per arsyet e punimeve lektrike qe jane te nevojshme per tu kryer ne objekt nje pjese e punimeve ne objekt si psh punimet elektrike ne lartesi kerkojne kategorine e III ose me larte, nje elektricist me kategorine e II nuk mund te kryej punime elektrike ne lartesi ose shtylle, kjo bazuar ne rregullat e sigurimit teknik., tekniket e ndertimit kerkohen per shkak te punimeve me karakter ndertimor qe ka objekti.

Tek Pika 2.2.6 dhe 2.2.7 kerkohet nje Ing Elektrik per arsyet e punimeve elektrike qe ka objekti dhe per zbatimin e punimeve ne objekt si dhe per zbatimin e rregullave te sigurimit teknik eshte i domosdoshem Ing elektrik per te bere drejtimin e punimeve. Ing. Gjeodet kerkohet per shkak te germimeve te shumta qe ka ky objekt dhe llojeve te ndryshme te kategorive te tokave te perfshira.

Pika 2.2.8 Automakinistet kerkohen per perdorimin e vincave minieskavatoreve per zbatimin e kontrates nje vlore e konsiderueshme e preventivin ka keto karakteristika punimesh

(Shënim- argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar punimet apo veprimitaritë konkrete për të cilat kerkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkeshat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, nëse është rasti, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2.2.9 Ne menyre qe te krahasohet pajtueshmeria me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara, operatori ekonomik ofertues per mallrat e meposhtem:

- **Tirantues abonentë**
- **Tirantues linje 4 x 16-95**
- **Kabell ABC 4 x1 6-95**

Operatori ekonomik duhet te paraqese:

1. Autorizim te prodhuesit/të distributorëve të autorizuar per listen e mesiperme te mallrave. Autorizimi duhet te permbate te dhena te plota te prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

Shenim: Operatori ekonomik /Bashkimi i operatoreve, duhet te ofertoje vetem me nje prodhues per secilin artikull, rastet kur paraqiten autorizime nga dy ose me shume prodhues per te njejtin artikull, perbejne objekt skualifikohet nga procedura.

2. Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve per listen e mesiperme, ne te cilet te tregohen dhe te specifikohen qarte materialet qe do te ofrohen.

Shenim: Fragmentet e katalogut/ve duhet te tregojne lethesisht dhe qarte qe jane pjesa katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese deshmi te testimeve zyrtare te kryera, te leshuara nga institucionet te autorizuara ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhua (lista mesiperme e materialeve) me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara.

2.2.10 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Mostra te mallit, ne permbushje me Specifikimet Teknike perfshire ne DST, ne oren dhe daten e percaktuar per hapjen e ofertave, prane zyrave te Drejtorise Rajonale OSSH Fier, artikujt mall si me poshte:

- **Tirantues abonentë**
- **Tirantues linje 4 x 16-95**
- **Kabell ABC 4 x1 6-95**

Argumentimi: Paraqitura e ketyre dokumenteve eshte vlerësuar nga njesia e prokurimit pasi duke qënë se në objektin e prokurimit kemi të bëjmë me blerjen e materialeve dhe pajisjeve që do të vendosen në punimet objekt kontrate, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto materiale e pajisje të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkovaar në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: Autorizim prodhuesi ose distributorin, katalogët ose pjesë të tyre, dëshmitë e testimeve të kryera, me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

2.2.12 Makineri dhe Pajisje

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tableles se meposhtme. Keto makineri dhe pajisje duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera të vërtetuara me dokumentacionin përkatës.

Eshtë e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës Nr.8. Ndërsa operatori ekonomik fitues, para lidhjes së kontratës, duhet të dorezoj dokumentacionin provues për cfarë kerkohet më poshtë i cili duhet të jetë orgjinal ose kopje e noterizuar:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; certifikate trasporti, çertifikate e kontrollit teknik; siguracion mjeti, (i vlefshëm).
- b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriele e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik, ; certifikate trasporti siguracion mjeti (i vlefshëm);
- c) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- d) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne një foto te vetme mjeti dhe targa e tij.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në shtojcën 8 në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara sipas shtojcës 8 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.
- g) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor gjate procesit te vleresimit te ofertave.

Nr	Lloji i Makinerive	Sasia	Gjendja
1	Kamion me vinç mbi 5 ton me karroceri per transport shtyllash	2 cope	Pronësi ose me qera
2	Kamion me kapacitet mbajtes 7- 10 ton	1 cope	Pronësi ose me qera
3	Kamioncina me kapacitet mbajtes 2-5 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
4	Fadrome me goma	2 cope	Pronësi ose me qera
5	Miniekskavator	1 cope	Pronësi ose me qera
	Pajisje Teknike		Pronësi ose me qera
1	Betoniere 300 litra	3 cope	Pronësi ose me qera

2	Kambaleca per mbajtjen e barabaneve te kabllove	2 cope	
3	Skavator	2 cope	Pronësi ose me qera
4	Kenotron per kabllo	1 cope	Pronësi ose me qera
5	Megaometer 2500-5000 V	1 cope	Pronësi ose me qera
6	Terrameter	1 cope	Pronësi ose me qera
7	Kokore	30 cope	Pronësi ose me qera
8	Komplet i ndihmes se shpejt	5 cope	Pronësi
9	Tabela paralajmeruese per sigurimin e perimetrit kantier	10 cope	Pronësi
10	Set veglash per kabllo TM (prerese kablli, presa hidraulike per kapikorda, Bombul Gazi me Kanello)	2 cope	Pronësi

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinave të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjisacionit të fushës, konkretisht

1. Analizat e çmimeve te zerave te preventivit jane marre ne baze VKM Nr. 629 date 15.07.2015
- 2 - Analiza e çmimeve te zerave qe nuk jane ne fletoren zyrtare jane bere ne baze te librit Nr.6 " Montimi i linjave dhe nestacioneve elektrike" dhe te manualit "Preventivimi per rrjetat elektrike komunal" sipas udhezimit Nr.2 date 08.05.2003 mbeshtetur ne VKM Nr.8402 date 10.09.1998
- 3 - Çmimet e bases materiale jane marre ne Drejtorene ekonomike te OSHEE (SAP - i) date 03.02.2015
- 4 - Volumet e germimeve, betonimeve dhe te montimeve jane marre sipas standarteve te OSHEE , bashkengjitur projektit.
- 5 - Paga orare eshte marre mesatarja e nje punonjesi te OSHEE 185 leke
- 6 - Sigurimet shoqerore jane marre 16.7 % sipas VKM VKM Nr. 629 date 15.07.2015.
- 7 - Per pumimet e ndertimit e te montimit ne baze te udhezimit Nr. 2 te date 08.05.2003 te VKM Nr. 8402 date 10.09.1998 eshte marre shtesa 50 % mbi page.
- 8 - Shpenzimet plotesuese jane marre 5 % sipas VKM Nr. 629 date 15.07.2015.
- 9 - Norma e fitimit eshte marre 10 % sipas VKM Nr. 629 date 15.07.2015.

(Shënim: përcaktoni aktin ligjor apo nënligjor, në bazë të të cilit është bërë përllogaritja teknike e numrit të punonjësve dhe mjetet/makineritë/pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës)

Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 4 (kater) muaj kalendarike, i cili fillon me dorezimin e sheshit te ndertimit dhe vazhdon per 4 (kater) muaj pa nderpreje normalisht deri ne perfundim, pavarsishtë vitit buxhetor.

Shënim: Autoreteti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1.
.....

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike te ngarkuara ne sistemin e APP-se jane hartuar nga specialistet perkates se teknikes sipas standardeve te derguara nga Drejtoria Qendrore, per procedure e siperpermendur.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përpjekje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkësë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tillë duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.



OSHEE
GROUP

Njesia e prokurimit